



TERMAT E REFERENCËS

Emri i Projektit	CV – Kujdesi Alternativ Qendra Mbështetëse për Fëmijë dhe Familje Programi i Fuqizimit të Familjes - Fushë Kosovë
Lloji i shërbimit	Shërbime të Supervizionit për Punonjësit që Ofrojnë Shërbime Profesionale për Sigurimin e Mirëqenijes së Fëmijëve dhe Familjeve në Nevojë.
Vendndodhja	Prishtinë dhe Fushë Kosovë
Kohëzgjatja	Janar, 2025 – Dhjetor , 2026
Data e pritshme e fillimit	Janar 2025
I raporton	SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë / Udhëheqësve të Njësive përkatëse

Hyrje

Fondacioni SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë është organizatë joqeveritare e përkujdesjes sociale e dedikuar për përkrahjen e fëmijëve të braktisur dhe në nevojë, pa marrë parasysh etninë, kombësinë dhe besimin fetar.

Fondacioni SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë përkujdeset për fëmijë të braktisur, pa përkujdesje prindërore dhe nevojtarë dhe, aktualisht ofron strehim, përkujdesje, edukim dhe përkrahje për afër 700 fëmijë përmes: Kujdesit Alternativ, Qendrës Mbështetëse për Fëmijë dhe Familje, Njesisë Nëna dhe Fëmija, Fuqizimi i Familjes në Fushë Kosovë

Kujdesi Alternativ përfshin strehimin dhe kujdesin për fëmijët dhe të rinjtë që kanë humbur kujdesin prindëror. Në kujdesin alternativ fëmijët dhe të rinjtë marrin shërbime nga kujdesdhënësit e tyre - SOS Nënat dhe SOS Tezet, stafin psiko-pedagogjik i përbërë nga psikologu, pedagogu, punëtori social si dhe dy BKR – Bashkëpunëtorët për Kujdesin e të Rinjëve. Rrjedhimisht ky është stafi që do të përfitojë nga seancat e supervizioni që po kërkohet.

Programi i Fuqizimit të Familjes në Prishtinë dhe Fushë Kosovë ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve të prindërve/kujdestarëve, në ofrimin e përkujdesjes cilësore për fëmijët si dhe vetëdijësimin e tyre për qasjen në shërbimet ekzistuese duke u bazuar në nevojat e anëtareve të familjes. Gjithashtu punohet në ngritjen e vetëdijësimit dhe zhvillimit të aftësive profesionale të tyre si dhe përgatitjen e tyre për tregun e punës, në mënyrë që familja të ketë vetqëndrueshmëri.



Qëllimi dhe Objektivat - SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë është e interesuar për ofrimin e seancave të supervizionit për punonjësit e organizatës. Me qëllim të ngritjes së kujdesit ndaj punonjësve, mbrojtjes nga djegja profesionale, ngritjes së bashkëpunimit ndërkolegial dhe ngritjes së motivit për punë ftojmë individ profesionistë të aplikojnë për ofrimin e shërbimeve të supervizionit.

Duke pasur parasysh të cekurat më lartë, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë kërkojnë profesionistë (Psikolog apo Psikiatër) me qëllim të ofrimit të shërbimeve të supervizionit për angazhim për këto grupe:

I- Supervizion për SOS Nënata nga SOS Familjet, pjesë e Kujdesit Alternativ;- Staf i kujdesdhënës grup i përbërë nga 6 përfitues, . Kohëzgjatja e seancës për grup 2h, një herë në muaj.

II- Supervizion për SOS Tezet nga SOS Familjet, pjesë e Kujdesit Alternativ; Staf i kujdesdhënës grup i përbërë nga 6 përfitues. Kohëzgjatja e seancës për grup 2h, një herë në muaj.

III-Supervizion për staf psiko-pedagogjik të Kujdesit Alternativ - (Grup i përbërë nga 4 persona). Kohëzgjatja e seancës për grup 2h, një herë në muaj.

IV-Supervizion për staf psiko-pedagogjik në projektin “Qendra Mbështetëse për Fëmijë dhe Familje” në Prishtinë (Grup i përbërë nga 10 persona). Kohëzgjatja e seancës për grup 3h, një herë në muaj si dhe

V- Supervizion për staf psiko-pedagogjik në Fushë Kosovë – (Grup i përbërë nga 4 persona). Kohëzgjatja e seancës për grup 2h, një herë në muaj.

Profesionistët që ofrojnë shërbime të supervizionit do të mbështesin punonjësit në gjetjen e menyrave të reja të punës duke inkurajuar praktika të reja të punës profesionale përmes diskutimeve konstruktive dhe konkrete.

Profesionistët që ofrojnë shërbime të supervizionit pritet të hartojnë një plan pune në raport me nevojat e prezantuara; Të jenë fleksibil/e në trajtimin dhe inkorporimin e modeleve të ndryshme të supervizionit gjatë punës; Të kenë ndjeshmëri të lartë në trajtimin e rasteve të prezentuara dhe mbrojtjes së konfidencialitetit të tyre.

Rezultatet e pritshme - Rezultatet e supervizionit pritet të ndikojnë pozitivisht në: ngritjen e kujdesit ndaj stafit, ngritjen e motivit për punë, mbrojtjen e punonjësve nga djegja profesionale, ngritjen e kohezionit dhe bashkëpunimit në mes punonjësve dhe rrjedhimisht edhe ngritjen e performancës në punë.

Dokumentet që duhet dorëzuar:

- CV-në;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Letër motivimi;
- Diplomat e shkollimit të fundit dhe certifikatat e trajnimeve;
- Letër referencat të cilat dëshmojnë eksperiencën në fushën relevante;
- Plan i punës dhe metodologjia e shërbimit;
- Oferta financiare -cmimin për 1 orë duhet të konsiderohet pagesë bruto

Vërtetimin që nuk jeni nën hetime (dorëzohet para nënshkrimit të kontratës)

Oferta duhet të jetë e vlefshme 30 ditë



Kriteret për përzgjedhje janë:

Kriteret	Pikët maksimale
<ul style="list-style-type: none">• Të ketë të përfunduar së paku studimet Master në Psikologji Klinike ose/dhe Këshillimi (Kanë përparësi profesionistët që kanë përfunduar shkollimin për supervizion);	20
<ul style="list-style-type: none">• Të ketë përvojë punë së paku 3 vite në fushën e psikologjisë klinike dhe/ose këshillimit si dhe në ofrimin e shërbimeve të supervizionit klinik, me orë të demonstruar apo dëshmi/ referenca.	20
<ul style="list-style-type: none">• Plani i punës dhe metodologjia e shërbimit.	20
<ul style="list-style-type: none">• Letër referencat;	10
<ul style="list-style-type: none">• Oferta financiare /çmimi për orë/ndaras për seanca individuale / seanca grupore.	30
Totali	100

Kohëzgjatja e kontratës – Shërbimet e supervizionit do të organizohen nga muaji Janar 2025 deri në Dhjetor 2026

Kushtet e pagesës - Pagesa do të bëhet nga SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, si pagese bruto në baza mujore dhe do të konsiderohet si pagesë nga punedhënësi i dytë, ndërsa ndalesa për tatim në të ardhurat personale dhe kontributi pensional do behet sipas ligjit në fuqi. Realizimi i pageses do behet në fund të çdo muaji në vartësi të orëve të realizuara dhe do të kryhet me transfer bankar, jo më vonë se 7 ditë nga pranimi i raportit mujor dhe evidencës së angazhimit.

Udhëzim për ofertuesit (Procesi i dorëzimit të Ofertave)

Ofertuesit janë të mirëpritur të paraqesin propozimin e tyre për ‘Supervizion – Prishtinë dhe Fushë Kosovë’ - në mënyrë elektronike në formatin PDF dhe në adresën elektronike: procurement1@soskosova.org.

Kjo Ftesë për Ofertë është e hapur për të gjithë individët që mund të ofrojnë shërbimet e kërkuara. Propozimi dhe të gjitha dokumentet plotësuese duhet të dërgohen në gjuhën shqipe.

Afati i fundit për dorëzim:

Afati i fundit për aplikim është: **06.12.2024**